



POLITIKAT E PRIVATËSISË

Platforma “**Deputeti që Duam**” është ngritur nga Partia Socialiste e Shqipërisë për të siguruar akses të drejtpërdrejtë dhe shprehjen e interesit të çdo shtetasi shqiptar që do të vetë propozohet si kandidat për deputet i Partisë Socialiste të Shqipërisë në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025.

Kjo politikë ju informon mbi mënyrën e mbledhjes dhe përdorimit të të dhënave personale të personave (përdoruesit) që regjistrohen për të përdorur platformën “Deputeti që Duam”. Përpunimi i të dhënave personale që ju vetë plotësoni dhe që mbledhen nga platforma kryhet pas dhënies së pëlqimit nga ana juaj dhe pranimit të kësaj politike të privatësisë. Personi konfirmon plotësimin dhe vërtetësinë e informacionit të dhënë duke deklaruar se ka plotësuar në mënyrë korrekte dhe të vërtetë të gjithë informacionin e kërkuar. Me plotësimin e aplikimit online, personi deklaron se jep miratimin e tij për përpunimin e mëtejshëm të informacionit të dhënë në platformën “*Deputeti që Duam*”.

BAZA LIGJORE:

1-Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.

2-Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

3- Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike dhe postare” si dhe aktet e tjera nënligjore plotësuese.

4- Rekomandimi i komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale Nr. 2, etj.

1. ÇFARË INFORMACIONI PËRPUNOJMË?

Platforma, nëpërmjet faqes në internet www.deputetiqeduam.al grumbullon të dhënat e personave të përdoruesve të kësaj platforme, që regjistrohen për të përdorur platformën për përcjelljen e kandidaturës së tyre dhe dokumentacionin shoqërues si: Jetëshkrimi, propozimi, foto/video. Të dhënat që mbledhen nga platforma pas regjistrimit të përdoruesit janë:

- Të dhënat e identifikimit: emri, mbiemri, datëlindja, vendlindja, vendbanimi.
- Të dhënat e kontaktit: adresa, e-mail, numri i telefonit.
- Të dhëna për arsimin, edukimin, punësimin.
- Mesazhe, foto, video që mbështesin aplikimin e kandidatit.

2. PËRSE E PËRDORIM INFORMACIONIN TUAJ?

- Të identifikoheni në faqen e internetit www.deputetiqeduum.al
- Të menaxhojmë procesin e vlerësimit, prezantimit dhe përzgjedhjes të kandidatëve për deputetë nga Partia Socialiste e Shqipërisë;
- Të menaxhojmë komunikimin me ju, t'ju përgjigjemi pyetjeve tuaja dhe t'ju dërgojmë mesazhe lidhur me zhvillimin e aktiviteteve dhe procesin e përzgjedhjes;
- Të publikojmë informacionin mbi kandidatët në platformën “Deputeti që Duam”, në faqen zyrtare web dhe faqet e medias sociale të Partisë Socialiste e Shqipërisë;
- Të promovojmë aktivitetet e platformës “Deputeti që Duam” dhe të kandidatëve, përgjatë fazave të ndryshme të përzgjedhjes në kanalet e mediave tradicionale dhe sociale;
- Të mbështesim aktivitetin e Partisë Socialiste të Shqipërisë gjatë fushatës zgjedhore të vitit 2025.

3. PËR VIZITORËT E TJERË TË PLATFORMËS

Për vizitorët në faqen e internetit www.deputetiqeduum.al, sistemi mbledh informacione standarde të cilat kanë të bëjnë me klikimet e artikujve apo rubrikave në këtë faqe. Ky informacion mbledhet për qëllime statistikore dhe studimi mbi përdorimin e faqes dhe profilit të kandidatëve, gjithnjë pa i bërë ata të identifikueshëm.

Ne e mbledhim këtë informacion në atë mënyrë që të mos identifikojmë asnjë vizitor. Ne nuk bëjmë asnjë përpjekje për të gjetur identitetin e vizitorëve që kanë vizituar platformën.

Ne nuk përdorim (dhe nuk lejojmë ndonjë palë të tretë) të përdorë mjete statistikore analitike për të ndjekur ose për të mbledhur informacione personale që i bëjnë të identifikueshëm vizitorët e platformës. Ne nuk lidhim asnjë të dhënë të grumbulluar nga kjo faqe me ndonjë të dhënë personale që e bën vizitorin të identifikueshëm nga çdo burim që të vijë, si pjesë e përdorimit tonë.

Nëse do të duam të mbledhim informacione personalisht të identifikueshme nëpërmjet platformës, ne do t'jua bëjmë të qartë rastin kur të mbledhim këtë informacion dhe do të shpjegojmë dhe arsyen e përdorimit të tij.

4. SIGURIA

Ne kemi merrë masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi. Sistemi i përpunimit të të dhënave nga përpunuesi përbusht të gjitha kriteret e ruajtjes dhe rrezikut të sulmeve kibernetike.

Përpunuesit e të dhënave që bien në kontakt me to plotësojnë një deklaratë për ruajtjen e tyre dhe mospërhapjen në mënyrë të tillë që të bie në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Në cilësinë e kontrolluesit të të dhënave personale të kandidatëve që do të hedhin të dhënat personale në platformë ne kemi marrë masat e sigurisë të përcaktuara në nenin 27 “Masat për sigurinë e të dhënave personale”, pika 2 të ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, i ndryshuar.

5. COOKIES

Cookies janë fragmente të vogla të tekstit të ruajtur në kompjuterin ose pajisjen tuaj mobile që ju dallojnë nga përdoruesit e tjerë. Ashtu si shumica e faqeve, dhe ato të faqes ëëë.deputetiqeduem.al përdorin cookies. Duke vizituar www.deputetiqeduem.al për herë të parë që ju jepni pëlqimin në përdorimin e cookies. Cookies që përdorim do të ruhen në pajisjen tuaj. Ju mund të refuzoni ose të ç’aktivizoni përdorimin e cookies nga shfletuesi juaj.

6. TË DREJTAT TUAJA

Ju duhet të keni parasysh se në zbatim të legjislacionit në fuqi mun të ushtroni të drejtat si më poshtë vijon:

- Të njiheni në çdo kohë me të dhënat personale të grumbulluara dhe të përpunuar për ju;
- Të kërkonit fshirjen e tyre;
- Të kërkonit kufizimin e përpunimit të tyre;
- Të korrigjoni çdo të dhënë personale të gabuar për ju; etj.

Nëse dëshironi të ushtroni ndonjë nga të drejtat e mësipërme ose keni ndonjë pyetje tjetër lidhur me të dhënat personale që lidhen me ju, ju mund të kontaktoni në adresën e email-it:

info@deputetiqeduem.al

Ne do të marrim masat në mënyrë direkte që duke respektuar të drejtat tuaja që burojnë nga zbatimi i ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, i ndryshuar, të orientojmë për zgjidhje sa më efektive kërkesën tuaj.

7. TË TJERA

- Subjekti kontrollues identifikon adresat dhe numrat e kontakti të subjekteve të të dhënave, për qëllime të caktuara apo të ndonjë ankese nga ana e tyre.
- Subjekti kontrollues i mundëson subjektit të të dhënave personale të drejtën e refuzimit me shkrim të pëlqimit të dhënë, në çdo kohë.
- Subjekti kontrollues kërkon miratimin (pëlqimin) nga subjekti i të dhënave personale që ky i fundit ka marrë dijeni dhe jep pëlqimin për përpunimin e të dhënave sipas përcaktimeve në politikën e privatësisë.
- Subjekti kontrollues ruajnë privatësinë e të dhënave personale, përditësimin e politikës së privatësisë herë pas herë, duke njoftuar edhe subjektet e të dhënave për ndryshimet e realizuara.